EUROPEAN CENTRE FOR MINORITY ISSUES KOSOVO

UNITED NATIONS TRUST FUND TO END VIOLENCE AGAINST WOMEN

KORNIZA INSTITUCIONALE DHE LIGJORE PËR MBROJTJEN E GRAVE PJESËTARE TË KOMUNITETEVE PAKICË NGA DHBGJ

Working Towards a Stable Multi-Ethnic Kosovo



Shënim i rëndësishëm: Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura në këtë botim nuk pasqyrojnë domosdoshmërish pikëpamjet e Fondit të Mirëbesimit të Kombeve të Bashkuara për t'i dhënë fund dhunës kundër grave apo ndonjë organizate tjetër nën drejtimin dhe ombrellën e Kombeve të

PËRMBAJTJE

I. HYRJE 3

II. KONTEKSTI I PROBLEMIT DHE SFIDAT ME TË CILAT NDESHEN GRATË DHE VAJZAT E KOMUNITETEVE PAKICË 3

III MEKANIZMAT INSTITUCIONALË PËR MBROJTJE KUNDËR DHBGJ-SË DHE DHUNËS NË FAMILJE ... 5

IV KUADRI LIGJOR PËR MBROJTJEN NGA DHBGJ DHE DHUNA NË FAMILJE 6

III. BOSHLLËQET DHE MANGËSITË NË KUADRIN E MIRATUAR LIGJOR DHE MEKANIZMAT AKTUALË INSTITUCIONALË NË DISPOZICION 7

IV. REKOMANDIME 8

I. HYRJE

Udhëtimi goxha i zhurmshëm drejt integrimit dhe anëtarësimit të Kosovës (sipas RKS 1244/1999 të OKB-së) në Bashkimin Evropian, si një shtet i posa formuar dëshmon të jetë një sfidë serioze. Rritja për tu konsideruar si një vend i pjekur dhe i qëndrueshëm, që do të ndikonte në rritjen e njohjeve ndërkombëtare dhe përmbushjen e të gjitha standardet të kërkuara kërkon shumë angazhim ndaj reformave themelore dhe atyre me ndikim të gjerë në shumë fusha. Në mes të listës së gjatë dhe të gjerë të gjërave të tjera, është raportuar se "dhuna me bazë gjinore dhe qasja e kufizuar e grave në të drejtën e tyre të pronësisë në mënyrë të konsiderueshme ka penguar që gratë të gëzojnë të drejtat e tyre të plota".[1] Shqetësim i veçantë është se gratë pjesëtar të komuniteteve pakicë ballafaqohen me rrezik të dyfishtë në këtë fushë, kryesisht për shkak të përkatësisë së tyre etnike dhe gjinore. Përmbledhja e politikave në vijim paraqet një përshkrim dhe analizë koncize/të saktë të kuadrit aktual institucional dhe ligjor për mbrojtjen e grave dhe vajzave pjesëtarë të komuniteteve pakicë në Kosovë (sipas RKS 1244/1999 të OKB-së) nga dhuna me bazë gjinore (në tekstin e mëtejmë 'DhBGj'), identifikon mangësitë dhe të metat e këtij kuadri dhe jep rekomandime të qarta për qeverinë e Kosovës (nën RKS 1244/1999 të OKB-së), gjykatat, policinë, shoqërinë civile dhe të gjitha palët e tjera përkatëse.

II. KONTEKSTI I PROBLEMIT DHE SFIDAT ME TË CILAT NDESHEN GRATË DHE VAJZAT E KOMUNITETEVE PAKICË

Konteksti I problemit dhe sfidat me të cilat përballen gratë dhe vajzat e komuniteteve pakicë

Gratë që i përkasin komuniteteve pakicë në Kosovë (sipas RKS 1244/1999 të OKB-së) - veçanërisht komuniteteve rom, ashkali, egjiptian dhe serbe - përballen me një diskriminim *de facto* të dyfishtë, së pari si gra dhe së dyti si pjesëtar të komuniteteve pakicë dhe janë të prekshme nga DhBGj. Në mesin problemet më të shprehura janë dhunë në familje (në tekstin e mëtejmë 'DhF') dhe martesat e hershme dhe ato të lidhura nën detyrim. Gratë e synuara kanë njohuri dhe qasje të kufizuar në parandalimin adekuat dhe shërbimet që ofrojnë trajtimin e këtyre rasteve në Kosovë (sipas RKS 1244/1999 të OKB-së). Shteti ka një kuadër ligjor dhe institucional që synon nxitjen e barazisë gjinore dhe parandalimin e DhBGj-së;

[1] Komisionit Europian, Raporti për *Kosovën 2015*, faqe 20. Në dispozicion në: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2015/20151110_report_kosovo.pdf

Megjithatë, zbatimi i këtij kuadri ligjor mbetet i pamjaftueshëm, veçanërisht në zonat ku jetojnë komunitetet pakicë, meqë gratë pjesëtar të këtyre komuniteteve përballen me pengesa shtesë gjuhësore, sociale dhe politike për të pas qasje tek shërbimet ekzistuese.

Si e përkufizon ligji DhBGj-në?

Sipas Ligjit për barazi gjinore të Kosovës (nën RKS 1244/1888 të OKB-së), "dhuna mbi baza gjinore përfshin të gjitha aktet e dhunës që rezultojnë në, ose ka të ngjarë të rezultojë në, dëm fizik, seksual, psikologjik, social ose ekonomik ose vuajtje në bazë të gjinisë, duke përfshirë edhe kërcënime për akte të tilla, detyrim apo privim arbitrar të lirisë, qoftë në publik ose në jetën private".[2] Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (në tekstin e mëtejmë "KEDKG") e përkufizon dhunën me bazë gjinore si "dhunë që drejtohet kundër një gruaje sepse ajo është grua ose që prek gratë në mënyrë jo-proporcionale. Konventa përfshin veprime që shkaktojnë dëmtim fizik, mendor apo seksual ose vuajtje nga kërcënimet për akte të tilla, shtrëngim dhe privime të tjera të lirisë".[3] Në anën tjetër, Dhuna në familje përkufizohet si "një apo më shumë veprime apo mosveprime të qëllimshme (ndër të tjera, përdorimi i forcës fizike ose presionin psikik, akte të padëshirueshme seksuale (pa pëlqim), dëmtim apo shkatërrim i pronës, detyrimi me forcë për dalje nga banesa e përbashkët) të kryera nga një person ndaj një personi tjetër me të cilin ai ose ajo është ose ka qenë në marrëdhënie familjare'.[4] Për më tepër, martesat e lidhura nën detyrim dhe ato të fëmijëve janë konsideruar si metodë për të zënë në grackë gratë dhe vajzat e reja, në një marrëdhënie që privon ato nga të drejtat e tyre themelore të njeriut dhe për këtë arsye këto lloje të martesave janë të ndaluara nga instrumentet e shumta ligjore ndërkombëtare.[5]

[2] *Ligjit për barazi gjinore*, nenet 3.1.18, në dispozicion në: http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/05-L-020%20a.pdf
[3] CEDAW, Rekomandime të përgjithshme Nr. 19. Në dispozicion në: http://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/recommendations/recomm.htm
[4] Ligji për mbrojtje nga dhuna në familje (LMDhF),neni 2.1.2. Në dispozicion në: http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2010-182-eng.pdf
[5] Avokatët për të drejtat e njeriut. Martesat e fëmijëve dhe ato të lidhura nën detyrim. Në dispozicion në: http://www.stopvaw.org/forced_and_child_marriage

III MEKANIZMAT INSTITUCIONALË PËR MBROJTJE KUNDËR DHBGJ-SË DHE DHUNËS NË FAMILJE

Çdo stacion *policor* ka një njësi përgjegjëse për dhunën me bazë gjinore.[6] Policia është përgjegjëse për t'iu përgjigjur çfarëdo lloji të raportimit apo lajmërimit për veprime apo kërcënime për të kryer akte të DhBGj-së/DhF-së, të arrestojnë kryesin e supozuar atëherë kur ekziston dyshimi i bazuar se është kryer një krim që ka përfshirë një rast të DhBGj/DhF dhe të përdorë mjete të arsyeshme për të mbrojtur viktimën dhe për të parandaluar dhunën e mëtejshme.[7]

Zyrtarët për barazi gjinore janë nëpunës civilë, në dispozicion në të gjitha komunat, ata/ato punojnë në drejtim të arritjes së barazisë gjinore dhe përfshirjen e çështjeve gjinore në politikat, legjislacionin dhe praktikat komunale.[8] *Qendrat për Punë Sociale (QPS-të)* mbikëqyren nga Ministria e punës dhe mirëqenies sociale (në tekstin e mëtejmë 'MPMS') dhe kanë një mandat për, ndër të tjera, të menaxhuar rastet e dhunës në familje.[9]

Strehimoret janë të kontraktuara nga MPMS-ja për të ofruar shërbime mbrojtëse për gratë dhe fëmijët që kanë përjetuar DhBGj/DhF. Gjashtë strehimoret, të vendosura gjithandej në Kosovë (nën RKS 1244/1999 të OKB-së), veprojnë si një koalicion strehimoresh në procedura, koordinim dhe avokim të përbashkët. Përveç strehimit, ato ofrojnë këshillim psikologjik dhe ligjor.[10]

Gjykatat komunale janë kompetente për shqiptimin e masave mbrojtëse të tilla si urdhra të ndryshëm mbrojtës për viktimat e mundshme ose faktike të DhBGj-së/DhF-së, të cilët urdhra duhet të ekzekutohen nga policia e Kosovës (nën RKS 1244/1999 të OKB-së).[11]

Përveç mekanizmave të përmendur më sipër, zyra për mbrojtjen dhe ndihmën e viktimave ka qenë e krijuar për të ndihmuar, ndër të tjera, viktimat e DhBGj-së/DhF-së, nëpërmjet mundësive dhe mjeteve si

[6] *Raporti i Komisionit Europian për Kosovën, 2015, faqe* 24.
[7] LMDhF, neni 24.
[8] Misioni i OSBE-së në Kosovë, Misioni i OSBE-së në Kosovë mbështet zyrtarët komunalë për barazi gjinore. Në dispozicion në: http://www.osce.org/kosovo/47900
[9] Färnsveden, Ulf, Ariana Qosaj-Mustafa, Nicole Farnsworth. Profili Gjinor i Shtetit: Një Analizë e dallimeve gjinore në të gjitha nivelet në Kosovë. Korniza Suedeze për Barazi Gjinore, 2014, f. 7. Në dispozicion në: http://www.swedenabroad.com/ImageVaultFiles/id_20757/cf_347/Orgut_Kosovo_Gender_Profile_FINAL_2014-05-08.PDF
[10] ECMI Kosova. Studim Bazik: Fuqizimi i komuniteteve pakicë në Kosovë kundër dhunës me bazë gjinore. Fondi i Mirëbesimit i Kombeve të Bashkuara për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave. Gusht 2014, faqe 26, në dispozicion në: https://ecmikosova.org/publication/baseline-study-empowering-minority-communities-in-kosovo-against-gender-based-violence/
[11] LMDhF, neni 3.

në vijim: ndihmës nëpërmjet të linjës së hapur dhe pa pagesë telefonike për raportimin në besueshmëri të plotë të llojeve të ndryshme të abuzimit; mbrojtësve të viktimave, të cilët janë përfaqësues të autorizuar për të ndihmuar dhe informuar të dëmtuarin/dëmtuarën për të drejtat e tij apo të saj, për më tepër, përfaqësojnë interesat e viktimës me prokurorin e shtetit dhe para një gjykate; dhe kur është e nevojshme, për t'i referuar viktimat tek ofruesit/institucionet e tjera të shërbimeve.[12]

IV KUADRI LIGJOR PËR MBROJTJEN NGA DHBGJ DHE DHUNA NË FAMILJE

Kushtetuta e Kosovës si akt më suprem ligjor, garanton mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut nga ana e autoriteteve të shtetit dhe ligjeve në fuqi.[13] Ligji për mbrojtjen nga dhuna në familje (në tekstin e mëtejmë 'LMDHF') është një ligj i veçantë që ka për qëllim për të parandaluar shfaqjen e DhBGj-së / DhF-së nëpërmjet masave të përshtatshme ligjore, për të trajtuar kryesit e rasteve të dhunës në familje dhe për të zbutur pasojat.[14] Ligje të tjera të veçanta për çështjet përkatëse (ligjet materiale), të tilla si Kodi Penal, Ligji për familjen, Ligji për trashëgimi, Ligji për shërbime sociale dhe familjare, Ligjin për shëndetësi, etj rregullojnë aspekte të caktuara të të drejtave të palëve të përfshira në raste të DhBGj-së/DhF-së.[15]

Sipas LMDhF-së, masat mbrojtëse që do të zbatohen kundër kryesve janë: trajtimi psiko-social, ndalimi për t'iu afruar viktimës së dhunës në familje, ndalimi i ngacmimit të personave të ekspozuar ndaj dhunës, largimi nga banesa, shtëpia ose ndonjë objekt tjetër i banimit, trajtimi mjekësor nga varësia e alkoolit dhe varësia nga substancat psikotrope dhe konfiskimi i sendit/mjetit me anë të të cilit është kryer akti i dhunës.[16] Masat të tjera mbrojtëse që duhet të zbatohen ndaj viktimës së dhunës janë: shoqërimi i viktimës së dhunës, masat mbrojtëse për sa i përket pronës, lëshimi i urdhrit përkatës mbrojtës dhe ndjekja penale e veprimeve të DhBGj-së/DhF-së që përbëjnë vepra penale të dënueshme sipas Kodit Penal dhe të ndjekura nga Kodi i procedurës penale.[17]

[12] Këshilli prokurorial I Kosovës. *Rregullorja për mandatin, strukturën dhe funksionimin e Zyrës për mbrojtje të viktimave*, neni 2, në dispozicion në: http://www.psh-ks.net/repository/docs/REGULATION_FOR_THE__MANDATE,_STRUCTURE_AND_FUNCTION_OF_THE_VPAO.pdf
[K]*Kushtetuta e Republikës së Kosovës*, Kapitulli i II, në dispozicion në: http://www.assembly-kosova.org/common/docs/Constitution1%20of%20the%20Republic%20of%20Kosovo.pdf
[14] LMDhF, neni 1.
[15] *Agjencia për barazi gjinore, Zyra e Kryeministrit. Komentet në Ligjin Nr. 03/L-182 për mbrojtje ndaj dhunës në familje (në tekstin e mëtejmë 'Komentet në LMDhF'). Prishtinë*, 2014, faqe 26.
[16] *LMDhF'*, nenet 4, 5, 6, 7, 9, 10.
[17] *LMDhF', nenet* 8, 11, 17, 26; *Komentet në LMDhF'*, faqe. 27.

III. BOSHLLËQET DHE MANGËSITË NË KUADRIN E MIRATUAR LIGJOR DHE MEKANIZMAT AKTUALË INSTITUCIONALË NË DISPOZICION

Kuadri ligjor i Kosovës në lidhje me DhBGj-në/DhF-në është mjaft gjithëpërfshirës, megjithatë, disa sfida mbesin të hapura për sa i përket zbatimit, veçanërisht në fushën e parandalimit të DhBGj-së/DhF-së, qasjen në drejtësi, rehabilitimin dhe ri-integrimin e viktimave të DhBGj-së/DhF-së. Puna e bërë në fushën e ndërgjegjësimit të burrave dhe djemve ndaj transformimit të roleve gjinore nuk është i kënaqshëm.[18]

Në zonat apo hapësirat ku jetojnë komunitete pakicë (Fushë Kosovë, Ferizaj, Graçanicë dhe Mitrovicë e Veriut), femrat pjesëtar të komuniteteve pakicë përballen me pengesa gjuhësore, sociale dhe politike për t'iu qasur shërbimeve ekzistuese që ofrojnë shërbime për parandalim dhe trajtim të rasteve të DhBGj-së/DhF-së. Në disa raste, zyrtarët përkatës nuk marrin parasysh çështjet gjinore dhe nuk janë të trajnuar mjaftueshëm për të siguruar ndihmën e duhur për viktimat e DhBGj-së/DhF-së siç të kërkuar nga ligji.
Policia - procesi i marrjes në pyetje i viktimave të DhBGj-së/DhF-së nuk përputhet me e teknikat e intervistimit dhe identifikimit të rasteve të dhunës në familje. Shpesh, zyrtarët përgjegjës për hetimin e këtyre rasteve nuk zgjedhin vendin e duhur për intervistë, nuk ushtrojnë kujdes të mjaftueshëm për të bërë pyetje të ndjeshme viktimave dhe për të siguruar se intervista është bërë në mënyrë diskrete dhe private.

Qendrat për Punë Sociale - procesi i decentralizimit ka krijuar vështirësi në ofrimin e shërbimeve për të gjitha komunitetet. Të mbijetuarit/at e DhBGj-së/DhF-së nuk trajtohen si një grup i posaçëm për qëllime të ndihmës sociale dhe miratimin e buxheteve për nevojat urgjente dhe ato të riintegrimit.[19]

Strehimoret apo shtëpitë e sigurta - vazhdojnë të kenë shumë kufizime, duke përfshirë sfidat për sa i përket qëndrueshmërisë dhe burimeve njerëzore. Viktimat e DhBGj-së/DhF-së zakonisht qëndrojnë për një periudhë të caktuar kohore dhe pastaj janë të detyruar të kthehen në banesën e përbashkët me kryesin e aktit të dhunshëm. Strehimoret/shtëpitë e sigurta nuk janë të pajisura me mjete të nevojshme financiare dhe njerëzore për fuqizimin e viktimave të DhBGj-së/DhF-së të cilët gjejnë strehë në këto

[18] *Country Gender Profile*, p. 2.
[19] *Study on Dimensions of Domestic Violence – Gender-based Violence in Kosovo Municipalities: Dragash/ Dragaš, Gjakovë/Djakovica and Gjilan/Gnjilane*. UNICEF: 2013

institucione, në mënyrë që ata/ato të zhvillojnë aftësitë e jetesës dhe njohuritë e kërkuara për të mbijetuar, kur ata/ato të jenë larguar nga strehimorja. Përveç kësaj, shërbimet e strehimit nuk janë në dispozicion për gratë pjesëtar të komunitetit serb në komunat e tyre (përpjekjet për të krijuar strehimore në Graçanicë dhe Mitrovicë Veriore janë akoma në vazhdim). Këto gra shpesh ndjehen të pasigurta që të vendosen në strehimoret në dispozicion në Prishtinë apo Mitrovicë të Jugut, strehimore këto të menaxhuara nga një personel që i përket komunitetit shqiptarë.

Gjykatat – në raste të ndryshme, gjykatat përkatëse nuk veprojnë në kohë reale siç u kërkohet, me qëllim për të parandaluar shfaqjen e dhunës. Në rastin e Gëzimit dhe Makfire Kastratit kundër Gjykatës Komunale të Prishtinës dhe Këshilli Gjyqësor të Kosovës, Gjykata Kushtetuese gjeti shkelje të së drejtës në jetë në emër të Diana Kastratit. Diana Kastrati kishte aplikuar për një urdhër mbrojtës nga Gjykata Komunale në Prishtinë. Gjykata nuk i është përgjigjur kërkesës së saj, siç i kërkohet nga ligji, rezultat i cili rezultoi me vrasjen e Diana Kastratit nga burri i saj. Një tjetër njollë e zezë në situatën e brishtë të sundimit të ligjit në Kosovë është vdekja brutale e Zejnepe Bytyçi-Berishës, duke qenë një thirrje e zëshme për kombin për të ndërmarrë veprime urgjente për rivlerësimin e efektivitetit të masave parandaluese dhe mbrojtëse të ofruara për rastet e DhBGj-së/DhF-së.[20]

Në përgjithësi, lëshimi i urdhrave të mbrojtjes pengohet nga mungesa e hetimeve të mjaftueshme të policisë dhe zbatimi i ligjit, ndikimi i kryesve të veprave tek gjyqtarët dhe prokurorët, etj. Rezultat i një neglizhence apo vonese të këtillë nga ana e gjykatave mund të jetë fatale, me ç'rast nuk mund të arrihet asnjë riparim i situatës fillestare. Për më tepër, gjykata në Mitrovicë të Veriut funksionon sipas ligjit të Republikës së Serbisë dhenë përgjithësi nuk i pranon rastet e dhunës në familje. Të mbijetuarit/at e dhunës që i përkasin komunitetit serb hezitojnë t'i dërgojnë/paraqesin rastet në gjykatën në Mitrovicë të Jugut.[21]

Zyra për Mbrojtje dhe Ndihme Viktimave – shumica e viktimave potencialë të DhBGj-së/DhF-së nuk janë të vetëdijshëm/me për ekzistimin e këtij mekanizmi.

IV. REKOMANDIME

[20] BIRN Kosovë, *OSBE e Zhgënjyer me reagimin e institucioneve ndaj rastit të Zejnepe Bytyqit*,në dispozicion në: http://live.kallxo.com/sq/MTL/OSBE-e-Zhgenjyer-me-Reagimin-e-Institucioneve-Ndaj-Rastit-te-Zejnepe-Bytyqit-9599; KOHA, *Viktima e burrit*, në dispozicion në http://koha.net/?id=27&l=81943; Anadolu Agency, *Kosovë: Gratë në Kosovë thonë "Mjaftë më!"*, në dispozicion në: http://aa.com.tr/sq/jeta/kosov%C3%AB-grat%C3%AB-n%C3%AB-kosov%C3%AB-thon%C3%AB-mjaft%C3%AB-m%C3%AB-/481320

[21] ECMI Kosova, Studim bazik, faqe 27.

ECMI Kosova i bën rekomandimet e mëposhtme për qeverinë e Kosovës (nën RKS 1244/1999 të OKB-së) dhe të gjithë aktorët relevantë që i dedikojnë punën e tyre krijimit të një mjedisi të sigurt dhe në miqësor për të gjitha gratë dhe vajzat pjesëtar të komu8niteteve pakicë në Kosovë:

(1) Është i nevojshëm një vullnet më i fortë politik dhe një ndarje e një shume të mjaftueshme të buxhetit për të siguruar **zbatimin e plotë dhe efektiv të kuadrit ligjor ekzistues,** veçanërisht kur trajtohen rastet e rrezikimit/cenueshmërisë së dyfishtë të viktimave të DhBGj-së/DhF-së.

(2) Ministria e punëve të brendshme do të duhej të zhvillojë teknikat të detajuara të marrjes në pyetje dhe të identifikimit të rasteve të dhunës në familje, në mënyrë që të lehtësohet puna e punonjësve të policisë brenda njësive të posaçme për trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore. **Zyrtarët përkatës të policisë** duhet të trajnohen **për të aplikuar një qasje pa-paragjykim gjatë procesit të intervistës dhe për të siguruar besueshmëri të plotë sa i përket informacionit të mbledhur**.

(3) Ministria e punës dhe mirëqenies sociale do të duhej të sigurojë një shumë më të lartë të buxhetit për nevoja emergjente dhe për riintegrimin e viktimave të DhBGj-së/DhF-së, **në mënyrë që viktimat të trajtohen si një grup specifik për efekt të ndihmës sociale dhe/ose ndonjë forme tjetër të ndihmës** që do të ofrohen nga Qendrat për punë sociale.

(4) **Themelimi i strehimoreve apo shtëpive të sigurta në Graçanicë dhe Mitrovicë Veriore** duhet të konsiderohet si një **domosdoshmëri urgjente** për gratë pjesëtar të komunitetit serb që janë viktima të DhBGj-së/DhF-së. Strehimoret aktualisht në dispozicion **duhet të jenë të pajisura me mjete të nevojshme financiare dhe njerëzore për fuqizimin e viktimave të DhBGj-së/DhF-së të akomoduar te këto strehimore, me qëllim për t'iu ofruar viktimave trajnime** për ngritjen e aftësive të tyre, zhvillimin e aftësive të tyre të jetesës dhe njohurive të nevojshme për të mbijetuar, kur ata/ato të largohen nga strehimoret/shtëpitë e sigurta.

(5) **Gjykatat duhet të aplikojnë një qasje të orientuar drejt viktimave kurdo që ato vlerësojnë nëse duhet të lëshohet urdhri përkatëse mbrojtës ose jo**. Parandalimi është gjithmonë më i rëndësishëm

se trajtimi. Përveç kësaj, gjykatat duhet të imponojnë dënimet më të larta në dispozicion për kryesit e akteve të DhBGj-së/DhF-së, siç të lejuara apo përcaktuara me ligj.

(6) Duhet të rritet niveli i ndërgjegjësimit **për t'i informuar viktimat e mundshme të DhBGj-së/DhF-së për ekzistencën e Zyrës për mbrojtjen dhe ndihmën e viktimave** si një mekanizëm i rëndësishëm dhe efektiv për ofrimin e ndihmës.

(7) Ekziston nevoja për më shumë investime **për aktivitetet e ngritjes së vetëdijes dhe fuqizimit nëpërmjet edukimit të grave dhe vajzave të reja pjesëtare të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, për të parandaluar martesat e hershme dhe ato të lidhura nën detyrim,** që janë akoma prezent dhe të përhapura te këto komunitete.

(8) Duhet të ndërmerren hapa inovativë në luftën kundër DhBGj-së/DhF-së **duke zhvilluar dhe zbatuar strategji për punë me/dhe përfshirje të burrave dhe djemve drejt transformimit të roleve gjinore**.

Kontaktoni/Vizitoni ECMI Kosovën

Sheshi “Nëna Terezë” Nr. 41, Apt. 29
10000 Prishtinë, Kosovë
Tel. +381 (0) 38 224 473

Rruga “Kralja Petra” I 183a,
38220 Mitrovicë e Veriut, Kosovë
Tel. +381 (0) 433 10 40

Email:info@ecmikosova.org
Web:ecmikosova.org